ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME**

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP:

Nr1 i prokurimit	**214-24-9531-1-1-1**
Nr i brendshëm	

Sa i përket tenderit për: **''Furnizimi me AC klima, perde dhe pjesë për pajisje elektronike për ndërtesat qeveritare dhe pallat të drejtësisë -Ritender''**

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

INFINITT SH.P.K.& ALFA. I SH.P.K. & KIGA SH.P.K.
(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

Rr.28 Nentori, no.121
(Adresa)

Prishtinë — *10.000*
(Vendi) — *(Kodi postar)*

044/974-590 — /
(Numri Telefonit) — *(Numri i Faks-it)*

Astrit Uka- menaxher
(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë

Infinitt.shpk@gmail.com
(Adresa elektronike)

23.12.2024.
(Data e parashtrimit të ankesës)

REPUBLIKA E KOSOVËS INFINITT SH.P.K Prishtinë

(Nënshkrimi dhe vula)

[1] Të raportohet në çdo dokument apo kërkesë në lidhje me këtë aktivitet të prokurimit

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

_____/_____
(Emri i avokatit)

_____/_____
(Adresa e plotë)

_____/_____ _____/_____
(Numri i Telefonit) *(Numri i faks-it)*

_____/_____
(Adresa elektronike)

_____/_____ _____/_____
(Data e parashtrimit të ankesës) *(Nënshkrimi dhe vula)*

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim te shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar " Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs te projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës","Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimi për anulim te aktivitetit te prokurimit", nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:

Njoftimi per kontrate: 13.09.2024 Afati i fundit për dorzimin e ofertav: 04.10.2024 Data dhe ora e hapjes se ofertav: 04.10.2024. ora 14:00 Njoftimi mbi vendimin e AK: 04.12.2024. Kriter per dhenie te kontrates: Tenderi i pergjegjshem me cmimin me te ulet

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, *nëse aplikohet*

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☐ **Jo** ☒ x

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, *nëse aplikohet*

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po [x] **Jo** [ ]

Letren standarde per tenderuesin e eleminuar se bashku me njoftimin mbi vendimin e AK i kemi pranuar ne e-prokurim me 04.12.2024.

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkese për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po [x] **Jo** [ ]

Nëse po, ofroni detaje mbi këtë fakt dhe bashkëngjit një kopje te vendimit te miratuar nga AK gjate kontekstit paraprak te zgjidhjes se mosmarrëveshjeve ne përputhje me nenin 108A te LPP-se.

Kerkesen per ri-shqyrtim te AK kemi dorezuar me 09.12.2024.
Vendimin per refuzim te kerkeses per ri-shqyrtim e kemi pranuar me 12.12.2024.

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Neni 1- Qellimi
Neni 6- Ekonomiciteti dhe Efikasiteti
Neni 7- Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi
Neni 10- Mjetet për promovimin e Transparencës
Neni 11- Informatat Sekrete Afariste
Neni 28- Specifikimet teknike
Neni 52- Njoftimi i kritereve për dhënien e kontratës
Neni 59- Ekzaminimi, vleresimi dhe krahasimi I tendereve
Neni 60- Kriteret per dhenie te kontrates
Neni 72.3- Dokumentacioni dhe informacioni shtesë
Neni 7 I Rregullores per prokurim public- Informata Sekrete afariste dhe Qasja në Dokumentacion
Neni 40 i Rrregullores per prokurim publik- Ekzaminimi, vleresimi dhe krahasimi i tendereve.

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkoj një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kane qenë te rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Këto terme janë përdorur shumë herë në tekstin e mëposhtëm prandaj edhe i kemi përdorur shkurtesat që kanë domethënie si në vijim:
AK- Autoritet Kontraktues
OE- Operator Ekonomik
LPP- Ligji i prokurimit publik
UOPP- Udhezimi operativ per prokurim publik

AK/Komisioni vlersues gjatë vlerësimit të ofertave për projektin në fjalë nuk ka vepruar në harmoni me LPP Nr. 04/L-042 I ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092 përkatësisht dispozitat ligjore të lartëcekura dhe Udhëzimin operativ e rregulloren për prokurim publik.
AK/zyra e prokurimit me 04.12. ka nxjere njoftimin mbi vendimin e autoritetit kontraktues dhe ka rekomanduar per kontrate OE Astech sh.p.k.
Kompania jone eshte eleminuar me arsyetimin se nuk kemi plotesuar specifikimet teknike per pjesen B perde elektrike te ajrit pasiqe niveli i zhurmes eshte me i larte se kerkesa e AK ne dosjen e tenderit, AK ne dosjen e tenderit ka pershkruar nivelin e zhurmes 60db mirepo nuk eshte percaktuar niveli maksimal ose minimal i lejuar nga AK qe ne kemi mare per baze se duhet te jete minimum 60db.
Duke mare per baze faktin se perdet elektrike do te vendosen ne hyrje te objekteve, niveli i zhurmes eshte faktor jo-determinues dhe i parendesishem pasiqe eshte hapesire e perbashket- koridore e jo zyre ku zhurma e kondicionerit do te pengonte punen dhe komunikimin mes paleve.
Siq eshte cekur ne katalog niveli i zhurmes ka ndikim/ndjeshmeri ne **1meter distance**, duke pasur parasysh se AK ka kerkuar qe perdet e ajrit te montohen ne **naltesi 4metra** ky nivel i zhurmes eshte fare i paverejtshem per veshin e njeriut apo ndikimin ne komunikim.
Per te faktuar kete qeshtje po marim per baze dhe sqarimet profesionale sipas te dhenave te nxjera nga kerkimet ne internet:
https://decibelpro.app/blog/how-loud-is-70-db/
Common Sources
Here is a list of sound sources that are 70 dB equivalent (on average):

- **A normal conversation: 60-70 dB**
- Open office noise: 65-75 dB
- An alarm clock: 70-80 dB
- Washing machine: 70 dB
- Dishwasher: 70 dB
- Restaurant: 70-80 dB
- Vacuum cleaner: 60-80 dB

Poashtu pasiqe qeshtja e njejte ka qene ne trajtim ne OSHP citojme vendimin e PSH nr. 2024/0545 ku OE Astech ishte ankuar per qeshtjen e njejte mosperputhjen e db mirepo ankesa eshte refuzuar pasiqe kemi te beje me devijim te vogel te paperfillshem dhe pa ndikim ne cilesine dhe efikasitetin e punes.

AK ne pergjigje te kerkeses per ri-shqyrtim sigurisht eshte bazuar ne ndonje vendim tjeter te OSHP-se pasiqe pretendimet/sqarimet te cilat AK ka dhene ne pergjigje te kerkeses per ri-shqyrtim nuk kane nderlidhje me vendimin nr. 2024/545.
Poashtu ne leter standarde per eleminim AK arsyetim ka cekur se nuk kemi ofruar katalog me specifikime teknike per pjesen C ne paramase, ne pjesen c jane kerkuar pjese rezerve per klimat ekzistuese te cilat posedon AK si te dergojme ne katalog p.sh per pllake per klime nuk mund te ofrojme katalog pa e ditur modelin e klimes te cilen AK posedon.
Ne kemi nenshkruar&vulosur specifikimet teknike ne dosjen e tenderit si dhe kemi dorezuar deklaraten per specifikime teknike me ane te ciles jemi zotuar se do ti permbahemi kerksave te AK lidhur me specifikimet teknike si ne aneks 1 te dosjes se tenderit.
AK nuk ka trajtuar barabarte ne kete procedure tenderimi OE ofertues pasiqe kompania jone eshte eleminuar per devijime te vogla te cilat teknikisht nuk paraqesin problem ne anen tjeter eshte rekomanduar per kontrate OE i papergjegjshem.
Me 05.12. kemi derguar kerkese per qasje ne dokumente zyrtare dhe me 06.12. AK na ka lejuar takimin per qasje ne dokumente zyrtare.
Duke u bazuar ne kerkesen per sekret afarist te kompanise Astech sh.p.k. AK nuk na ka lejuar qasje ne dokumentet:
Lista e kontratave, Referencat, deklaratat e ATK, katalogun, listen e stafit dhe dokumentet per stafin.
AK ne kete rast ka vepruar jashteligjshem dhe nuk ka respektuar nenin 11 te LPP-se, pika 3.3 citoj:

> 3.3 kërkesa e tillë me shkrim të përmbajë një deklaratë me shkrim (i) në të cilën vërtetohet se **një element i tillë nuk është pronë publike**, dhe se të dhënat mbrohen nga operatori ekonomik nga zbulimi i qëllimshëm ose nga pakujdesia, dhe (ii) me të cilin parashtrohen arsyet, që bindshëm demonstrojnë, sipas gjykimit të arsyeshëm të autoritetit kontraktues, se qasja publike në elementin e tillë do të rezultonte në dëmtimin material të interesave legjitime komerciale të operatorit të tillë ekonomik.

Ne edhe ne qasjen ne dokumente zyrtare kemi tentuar disa here qe te bindim perfaqesuesin e AK qe te na lejoje perkatesisht te na barte ne USB katalogun e dorezuara nga OE i rekomanduar per kontrate pasiqe eshte prone publike te cilin prodhuesi e ka bere publike dhe mund te gjindet nga nje kerkim i thjeshte ne internet, ne kete menyre nuk mund te klasifikohet si sekret afarist i OE Astech.
Keto dokumente jane publike dhe nuk mund te klasifikohen si informata sekrete afariste per OE ofertues pasiqe kete nuk e kerkon as prodhuesi, ne te kunderten nuk do te beheshin publike ne web-faqe per secilen pale te interesuar.
Duke mare parasysh dhe faktin se OE Astech ne kerkesen per sekret afarist nuk ka paraqitur deklarate mbi natyren e demit material nese keto dokumente behen publike per palet tjera, AK eshte dashur qe te refuzoje kerkesen per sekret afarist te paraqitur nga OE Astech duke mare parasysh faktin se nuk ka paraqitur nje deklarate me shkrim mbi arsyejet qe bindshem demonstrojne, sipas gjykimit te arsyeshem se qasje publike ne elementin e tille do te rezultonte ne demtim material te interesave legjitime, komerciale te operatorit ekonomik.
Bazuar dhe ne nenin 7.6 te rregullores per prokurim publik:
Informatat sekrete afariste dhe qasja në dokumentacion
7.6.1 Autoriteti Kontraktues nuk do të klasifikojë një informatë si sekret afarist, nëse OE nuk e ka plotësuar Aneksin 3 të Dosjes së tenderit me të gjitha informacionet e kërkuara në këtë formular, me theks të veçantë poqëse nuk i ka paraqitë të gjitha faktet dhe argumentet me 2 të cilat OE dëshmon se zbulimi i një informacioni do t'i shkaktojë dëm material biznesit të tij.

Edhe vete AK/ Zyra e prokurimit ne pergjigje te kerkeses per ri-shqyrtim ka theksuar nenin 11 paragrafi 3.3 sipas te cilit OE obligohet qe te paraqese nje deklarate me shkrim me te cilen vertetohet se nje element i tille nuk eshte prone publike.
Lidhur me kete qeshtje perveq dorezimit te ankeses ne detyrohemi ti drejtohemi dhe Agjensionit per informim dhe privatesi per te kerkuar te drejten elementare e cila na takon me ligj.
Ne kemi dyshimet tona se OE nuk ka dorezuar katalogun me specifikime teknike per te gjitha produktet dhe AK me qellime qe te favorizoje OE ne fjale ka kerkuar sqarime shtese dhe ka pranuar dokumente ne menyre jo-ligjore duke mos respektuar nenin 72.3 te LPP-se.
Pasiqe AK nuk na ka lejuar qasje ne dokumentet e OE Astech shpk dhe nuk mund te paraqesim me shume pretendime ankimore lidhur me kete qeshtje kerkojme nga eksperti shqyrtues qe edhe njehere te verifikoje deshmite e dorezuara ne ofertim dhe si sqarime shtese nga OE i rekomanduar per kontrate.
Siq kemi mund te verejme ne monitorin e zyrtarit te prokurimit OE i rekomanduar per kontrate ka ofertuar me modelin e klimav Nitto AIKO II series.
Nga kerkimet ne internet te ketyre modeleve kemi verejtur dhe se OE i rekomanduar per kontrate nuk ploteson specifikimet teknike te parashtruara ng AK si ne dosjen e tenderit per pozicionin A2- kondicioner 12 BTU A3- kondicioner 18 BTU dhe pozicionin A4- kondicioner 24 BTU.
Sipas shenimeve ne linkun https://esoldatos.gr/en/shop/air-conditioning/split-type/klimatistiko-mixanima-12000-btu-aiko-12ei-nitto/ per pozicionin A2 klima 12BTU eshte kerkuar
Declared heating capacity**:** 2420(1000~3810) ndersa eshte ofruar 3420
Si dhe eshte kerkuar Indoor sound pressure(S/H/M/L/ Mute) dB(A) 40/37/33/25/**22** ndersa eshte ofruar 40/37/33/25/**19**
Sipas shenimeve ne linkun https://esoldatos.gr/en/shop/air-conditioning/split-type/klimatistiko-mixanima-24000-btu-aiko-24%CE%B5%CE%B9-nitto/ per pozicionin A4 eshte kerkuar Indoor sound power(S/H/M/L/ Mute) dB(A) 54/51/48/**44** ndersa modeli i ofruar 54/51/48/44/**40,** Outdoor sound power dB(A) **67** / ndersa eshte ofruar **57.** Keto te dhena duhet te verifikohen online nga AK pasiqe katalogu i OE ofertues nuk paraqet te dhena reale, ne disa pika te dhenat jane edituar per tu perfshtatur me kerkesat lidhur me specifikimet teknike si ne ANEKS 1 te DT. Ne kete menyre OE ka vene ne lajthitje komisionin vleresues te cilet kane mare si te mireqene te dhenat teknike te paraqitura ng OE Astech ne katalog.
OE i rekomanduar per kontrate poashtu eshte i papergjegjshem pasiqe nuk ka paraqitur ne katalog te dhenat lidhur me EER declared/ COP declared dhe Pdesignh Average. Nuk e dime si ka bere vleresim te ketyre specifikimeve teknike AK kur fare nuk jane paraqitur ne katalog, per kete pretendim ankimor AK fare nuk eshte deklaruar ne pergjigje te kerkeses per ri-shqyrtim.
Megjithese keto jane devijime te vogla dhe nuk qojne peshe ne lenden e aktivitet te prokurimit, AK edhe kompanine tone ka eleminuar per devijime te vogla/mosperputhje minore te cilat fare nuk kane ndikim ne realizimin e projektit, AK/zyra e prokurimit ne vleresimin e ofertave ka perdorur standarde te dyfishta.
Mare parasysh faktet e lartecekura konstatojme se AK/komisioni vleresues ka rekomanduar per kontrate OE te papergjegjshem i cili ne baze te modeleve te klimave te cilat ka ofertuar nuk ka plotesuar te gjitha specifikimet teknike te parashtruara ng AK si ne ANEKS 1 te dosjes se tenderit dhe ne paramase dhe kompania jone eshte

eleminuar pa te drejte megjithese kemi plotesuar te gjitha kriteret dhe kerkesat e parashtruara nga AK ne dosjen e tenderit.

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.

Si pasoje e shkeljeve te lartecekura nga AK/komisioni vleresues ka ardhe deri tek dhenia e kontrates per OE te papergjegjshem ne kete menyre nuk jane respektuar dispozitat ligjore te lartecekura.
Kompanise sone i eshte mohuar e drejta e fitimit te nje kontrate publike megjithese kemi qene oferta e pergjegjshme me cmimin me te ulet te dorezuar ne kete aktivitet te prokurimit, ne anen tjeter eshte demtuar buxheti publik perkatesisht MPB per 31,025.00euro duke u rekomanduar per kontrate oferta me cmimin me te larte te dorezuar ne kete aktivitet te prokurimit.
Kerkojme nga Organi shqyrtues i prokurimit qe pas shoshitjes se provave dhe fakteve te aprovoje ankesen e kompanise sone si te bazuar dhe lenda te kthehet ne ri-vleresim.

10. Lista e dokumenteve (dëshmive) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

a) *një kopje të publikimit të "Njoftimit për Kontratë" apo "Njoftimit për Konkurs të Projektimit.*
b) *një kopje të publikimit për "Njoftimin e Dhënies së Kontratës" apo "Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimit për Anulim".*
c) *një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.*
d) *një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,*
e) *bashkëngjit një kopje te vendimit te miratuar nga AK gjate kontekstit paraprak te zgjidhjes se mosmarrëveshjeve ne përputhje me nenin 108A te LPP-se,*
f) *Dëshminë e pagesës se tarifës se ankimit ne përputhje me nenin 118 te LPP-se, dhe*
g) *të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.*

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*